

PYETJE DHE PËRGGJIGJE RRETH COVID-19

Fakte bazike¹

1. ÇFARË ËSHTË SARS-COV-2? ÇFARË ËSHTË COVID-19?

Sindroma Akute e Rëndë e Frymëmarrjes Coronavirus-2 (SARS-CoV-2) është emri që i është dhënë koronavirusit të ri të vitit 2019. COVID-19, është emri që i është dhënë sëmundjes së lidhur me virusin SARS-CoV-2, është një formë e re e koronavirusit që nuk është identifikuar më parë te njerëzit.

2. NGA VIJNË KORONAVIRUSËT?

Koronavirusët janë viruse që qarkullojnë midis kafshëve. Disa koronavirusë mund të infektojnë njerëzit.

Lakuriqët e natës konsiderohen bartës natyralë të këtyre viruseve dhe disa lloje të tjera të kafshëve dihet gjithashtu se veprojnë si burime. Për shembull, Koronavirusi i Sindromës së Frymëmarrjes në Lindjen e Mesme (MERS-CoV) transmetohet tek njerëzit nga devetë, ndërsa Sindroma Akute e Rëndë e Frymëmarrjes Coronavirus-1 (SARS-CoV-1) transmetohet te njerëzit nga bartës të ndërmjetëm, si p.sh. macet civet që kishin rol në shfaqjen e SARS-CoV-1.

3. A ËSHTË KY VIRUS I KRAHASUESHËM ME SARS OSE ME GRIPIN SEZONAL?

Koronavirusi i ri i zbuluar në Kinë në 2019 është i lidhur ngushtë gjenetikisht me virusin SARS-CoV-1. SARS u shfaq në fund të vitit 2002 në Kinë dhe shkaktoi më shumë se 8 000 raste në 33 vende gjatë tetë muajve. Rreth një në 10 njerëz, që kishin SARS vdiqën.

Në njëmbëdhjetë muajt e parë të pandemisë COVID-19 (nga 31 Dhjetor 2019 në 14 Dhjetor 2020), kishte mbi 71 milion raste në të gjithë botën dhe më shumë se 1 600 000 vdekje.

4. SI PËRHAPET VIRUSI?

SARS-CoV2 transmetohet kryesisht përmes piklave të frymëmarrjes dhe aerosoleve nga një person i infektuar kur tështin, kollitet, flet ose merr frymë dhe është në afërsi të njerëzve të tjerë. Virusi është izoluar gjithashtu në jashtëqitjet e rasteve të infektuara, duke treguar që transmetimi fekal-oral mund të jetë gjithashtu një rrugë e infeksionit. Pikat mund të thithen ose mund të zbresin në sipërfaqe, me të cilat të tjerët bien në kontakt dhe më pas infektohen kur prekin hundën, gojën ose sytë. Virusi mund të mbijetojë në sipërfaqe nga gjithçka, ndërmjet disa orësh (bakër, karton) deri në një numër ditësh (plastike dhe çelik inox). Sidoqoftë, sasia e virusit të qëndrueshëm, bie me kalimin e kohës dhe mund të mos jetë gjithmonë e pranishme në sasi të mjaftueshme për të shkaktuar infeksion.

Periodha e inkubacionit për COVID-19 (d.m.th. koha midis ekspozimit ndaj virusit dhe shfaqjes së simptomave) aktualisht vlerësohet të jetë ndërmjet një dhe 14 ditë.

¹ https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/---ifp_skills/documents/publication/wcms_741287.pdf

Në e dimë që virusi mund të transmetohet kur njerëzit që janë të infektuar shfaqin simptoma të tilla si kollitja. Një person që është i infektuar gjithashtu mund të transmetojë virusin deri në dy ditë para se të shfaqin simptoma; shkalla në të cilën infeksione të tilla asimptomatike kontribuojnë në transmetimin e përgjithshëm nuk është aktualisht e qartë.

5. KUR ËSHTË NJË PERSON INFEKTIV?

Periudha infektive mund të fillojë rreth dy ditë para se të shfaqen simptomat, por njerëzit janë më infektivë gjatë periudhës simptomatike, edhe nëse simptomat janë të lehta dhe jo specifike. Periudha infektive vlerësohet të zgjasë për tetë deri në 10 ditë në raste të moderuara dhe deri në dy javë mesatarisht në raste të rënda.

6. SA I RËNDË ËSHTË INFEKSIONI COVID-19?

Të dhënat nga BE / Zona Ekonomike Evropiane (nga ato vende me të cilat disponohen) faktojnë se deri në 30% të rasteve të diagnostikimit me COVID-19 hospitalizohen, varësisht nga mosha dhe deri në 20% të atyre që hospitalizohen kanë nevojë për mbështetje ventiluese. Është e duhur të theksohet, megjithatë, se ata me simptoma më të rënda, kanë më shumë gjasa të testohen sesa ata me simptoma më pak të rënda. Përqindja aktuale dhe kërkesa që kërkon pranim në spital nga numri i përgjithshëm i individëve të infektuar është më e ulët sesa sugjerojnë këto shifra. Normat e shtrimit në spital janë më të larta për ata të moshës 60 vjeç e lart dhe për ata me shëndet të përkeqësuar.

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.